

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo		Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo		CAA	
Nr. i prot. <u>3011/2024/66</u>					
Bërdit./Prot. tit.					
Faqe <u>4</u>	Kopje <u>-</u>	Datë: <u>20/03/2022</u>			
Stranica/Pages	Kopije/Copy	Datum/Date			
Hyrës/Intrada		☐		☒	
Datis/izlazi/Out		☒		☐	
Bërdshëmtë/Intrada/Intrada		☐		☐	
Pristitina/Pristina/Pristina					

Nr. 03/ZDP/VE/2022
Datë: 9 mars 2022

Në mbështetje të nenit 14.1, 14.2, 15.1(f), 21.2 dhe 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, 4 qershor 2008), dhe nenit 13.1 të Rregullores së AAC-së nr. 3/2015 mbi tarifat e aeroportit, datë 8 qershor 2015,

Duke vendosur sipas propozimit final të operatorit të aeroportit, LKIA ANP "Adem Jashari" ("operatori i aeroportit"), dt. 01 shkurt 2022, për aprovim të Programit Nxitës 2022-2024 me nr. Prot. 2022/ZDP/34;

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës nxjerr këtë:

VENDIM

1. Aprovohet Programi Nxitës 2022-2024 për ANP "Adem Jashari" sipas propozimit final të operatorit të aeroportit, dt. 01 shkurt 2022 me nr. protokoli 2022/ZDP/34.
2. Aprovimi i AAC-së mbulon vetëm produktet të cilat prekin tarifat e rregulluara nga AAC-ja: produkti 7.3 Nxitja për stacionimin e aeroplanëve (modulimin e tarifës së parkimit të aeroplanëve prej 100%) dhe produkti 7.4 Nxitja për zhvillimin e destinacioneve të largëta (modulimin e tarifës së aterimit prej 100%) në përputhje me këtë vendim.
3. Programi është efektiv për periudhën 27 mars 2022 – 30 mars 2024.
4. Operatori i aeroportit obligohet që të publikojë programin nxitës në faqen e tij zyrtare në internet.
5. Operatori i aeroportit obligohet që të informojë AAC-në mbi zbatimin e këtij programi.
6. Çdo ndryshim i programit nga operatori i aeroportit duhet të aprovohet nga AAC-ja.
7. Kompanitë ajrore mund të ankojnë në AAC në rast se janë të pakënaqur me zbatimin e Programit Nxitës nga operatori i aeroportit.
8. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

75

ARSYETIM

Operatori i aeroportit ka dorëzuar propozimin final të Programit Nxitës 2022-2024 për marrjen e aprovimit nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës ("AAC") më dt. 01 shkurt 2022 (nr. prot. 2022/ZDP/34 dt. 01 shkurt 2022) dhe rezultatet e konsultimit.

Me qëllim të marrjes së aprovimit të AAC-së për produktet 7.3 Nxitja për stacionimin e aeroplanëve dhe 7.4 Nxitja për zhvillimin e destinacioneve të largëta të përfshira në Programin Nxitës, operatori i aeroportit ka dorëzuar këto dokumente për shqyrtim:

1. Propozimin fillestar të programit nxitës me titull "Draft incentive e PLA 2022-2024" me numër të protokollit 2021/ZDP/383 dt. 30 dhjetor 2021;
2. Komunikimin elektronik të datës 28 dhjetor 2021 prej LKIA te kompanitë ajrore me titull "Draft incentive e PLA 2022-2024", përmes të cilit kërkojnë komentet në programin nxitës 2022-2024 deri më 14 janar 2022;
3. Listën e pranuesve të komunikimit të lartë përmendur;
4. Korrespondencën përmes e-mailit mes Wizzair dhe LKIA sa i përket produkteve 7.1, 7.4 dhe 7.5 të programit;
5. Korrespondencën përmes e-mailit mes Turkish Airlines dhe LKIA sa i përket produkteve 7.1 dhe 7.2 të programit.
6. Komunikimet me LKIA lidhur me kërkesën e AAC-së sa i përket pikës a) dhe b) të nenit 12 të Rregullores, që janë përmbyllur me dorëzimin e dt. 1 mars 2022.

Në bazë të detyrave dhe përgjegjësi të AAC-së sipas nenit 15(f) të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil si dhe nenit 8 të Rregullores nr. 3/2015 për tarifat e aeroportit, AAC-ja ka bërë shqyrtimin e këtyre dokumenteve dhe:

KA KONSTATUAR SE:

- Programi nxitës i propozuar është një iniciativë transparente dhe inkurajim i mirë për kompanitë ajrore që të fillojnë destinacione të reja më të largëta ose të stacionojnë aeroplan në ANP "Adem Jashari". Zbatimi i këtyre nxitjeve do të jetë i dobishëm për publikun ngase rritë mundësitë për të udhëtuar nga ANP "Adem Jashari";
- Kushtet për dhënie të nxitjeve nr. 7.3 dhe 7.4 të ofruara në Programin Nxitës të propozuara nga operatori i aeroportit e të cilat rregullohen nga AAC-ja janë relevante, objektive dhe transparente;
- Programi Nxitës i ofrohet të gjitha kompanive ajrore pa asnjë përjashtim të cilat bartin udhëtarë dhe operojnë ose planifikojnë të operojnë nga ANP "Adem Jashari" dhe të cilat plotësojnë të gjitha kushtet;
- Programi Nxitës është i limituar në kohë dhe është efektiv për periudhën 27 mars 2022 - 30 mars 2024;
- Konsultimi me përdoruesit është bërë në periudhën 28 dhjetor 2021 - 14 janar 2022 dhe në bazë të listës së kompanive ajrore të konsultuara është vërtetuar se janë konsultuar të gjitha kompanitë që operojnë momentalisht në aeroport;

- Komentet e kompanive ajrore kanë pasë të bëjnë me intensitetin dhe strukturën e nxiqeve dhe prekin tarifa që nuk rregullohen nga AAC. Përkundër kësaj, AAC ka shqyrtuar komentet e kompanive ajrore dhe ka pasur komunikim me operatorin sa i përket pyetjeve të kompanive ajrore.
- LKIA ka pranuar të ndryshojë propozimin që të merren parasysht rekomandimet e AAC-së të prezantuara gjatë takimit të datës 21 janar 2022:
 - Të qartësohet pika 6 (te propozimi final) për të përfshirë vetëm rrethanat që janë të pakontrollueshme nga të dyja palët;
 - Të ulët kriteri që ka të bëjë me përqindjen e frekuencave të operuara respektivisht nga 95% në 90% për shkak se pandemia ende mund të çrregulloj operimet;
 - Të lejohet peshja më e ulët e aeroplanëve se 55,000 kg në pikën 7.4(c) (te propozimi final);
 - Ndryshimet në produktet tjera kanë ofruar qartësime por nuk janë në fushëveprimin e AAC-së.

Nga të dhënat e ofruara për të hyrat e parashikuara dhe shpenzimet si rezultat i nxiqes të ofruara në përputhje me Nenin 12 a) dhe b), shihet se LKIA do të gjenerojë të hyra neto shtesë, pra se nxiqet e rregulluara nga AAC do të kenë efekt pozitiv në biznesin e aeroportit.

Përmes korrespondencës elektronike të dt. 25 shkurt 2022 në lidhje me kërkesën e AAC-së për të marrë pajtueshmëri nga Partneriteti Publik i Marrëveshjes PPP në ANP, rreth programit nxitës të propozuar nga operatori i aeroportit, Departamenti Qendror për Partneritet Publiko Privat i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve nuk ka dhënë ndonjë vërejtje dhe ka kështu AAC-në të vazhdojë ushtrimin e përgjegjësiive brenda kompetencave dhe autorizimeve të saj.

Duke marrë parasysht se Programi nxitës 2022-2024 i propozuar nga operatori i aeroportit është një iniciativë transparente dhe inkurajim i miutë për kompanitë ajrore që të fillojnë destinacione të reja më të largëta ose të stacionojnë aeroplan në ANP “Adem Jashari”, është i kufizuar në kohë (vlen për dy vite), është proporcional me arrijtjen e objektivit të synuar dhe i ofrohet të gjitha kompanive ajrore pa përjashtim, mund të përfundohet se, si i tillë, ky program është në interes të përgjithshëm publik dhe në përputhje me kërkesat e nenit 13.1 të Rregullores nr. 3/2015 për tariffat e aeroportit.

Duke u mbështetur mbi këtë bazë ligjore, Drejtori i përgjithshëm ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 9 mars 2022



Udhëzim mbi mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të kërkohet rishikim administrativ pranë Komisionit të Ankesave të AAC-së, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Iu dërgohet:

- Operatorit të ANP "Adem Jashari" LKIA
- Departamentit Qendror PPP, MFPT
- Departamentit të Aviacionit Civil, MMPHI